



UT - Fakulteti i Filologjik - Republika e Maqedonisë së Veriut
УТ - Филолошки Факултет - Република Северна Македонија
Nr. Бр. 15-389/1
12.06.2025 vll/rnq.
Tetovë - Tetovo

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në përputhje me Ligjin për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18, 178/21, 58/24), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit Filologjik dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik, shpallet:

KONKURS

për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik në Universitetin e Tetovës

I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestër veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.

II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:

- biografi (CV);
- vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025;
- vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar.

III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: Universiteti i Tetovës (Fakulteti Filologjik) rr. “Ilinden”, p.n., 1200, Tetovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 20.06. 2025.

IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Tetovë, më 12. VI. 2025



Kryetar i Komisionit Zgjedhor

Prof. dr. Majlinda NUHIU